

GJYKIMET PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS GJATË VITIT 2021

BULETIN / JANAR 2022



PËRMBAJTJA

PROKURORI I SPECIALIZUAR
KUNDËR SALIH MUSTAFËS

PROKURORI I SPECIALIZUAR
KUNDËR HYSNI GUCATI DHE
NASIM HARADINAJ

PROKURORI I SPECIALIZUAR
KUNDËR HASHIM THAÇIT DHE
TË TJERËVE

PROKURORI I SPECIALIZUAR
KUNDËR PJETËR SHALËS

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) monitoron proceset gjyqësore që zhvillohen pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. FDHK publikon buletine dhe analiza që lidhen me punën e Dhomave të Specializuara të cilat i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur informatat e përgjithshme mbi ecurinë e gjykimeve para Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) përgjatë vitit 2021.

Për momentin pranë DHSK janë duke u trajtuar katër (4) rastet. Tre rastet kanë të bëjnë me krimet e luftës: Prokurori kundër Salih Mustafës; Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve; dhe Prokurori kundër Pjetër Shalës. Kurse rasti Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt ka të bëjë veprat penale kundër pengimit të administrimit të drejtësisë.

Rasti Prokurori kundër Salih Mustafës dhe rasti Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt gjenden në shqyrtim kryesor kurse dy rastet e tjera janë ende në procedurën paraprake.



Gjatë vitit 2021 pranë DHSK janë mbajtur gjithsej gjashtëdhjetë e tetë (68) seanca gjyqësore dhe janë dëgjuar tetëmbëdhjetë (18) dëshmitarë.

Deri në përfundim të vitit 2021 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë **akuzuar tetë (8) persona** dhe të gjithë të pandehurit gjenden në paraburgim në Hagë.

PROKURORI I SPECIALIZUAR KUNDËR SALIH MUSTAFËS

Gjykimi i parë pranë DHSK ka filluar në shtator të vitit 2021 në rastin Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës. I pandehuri akuzohet për krime lufte sipas të drejtës ndërkombëtare.

Gjykimi në këtë rast zyrtarisht filloi me 15 shtator të vitit 2021 me deklaratat hyrëse të ZPS-së dhe përfaqësuesit të viktimave.

Gjatë vitit 2021, në këtë rast janë mbajtur **njëzet e shtatë (27) seanca**, prej të cilave dy (2) kanë qenë konferenca mbi ecurinë e çështjes, dy (2) kanë qenë konferenca përgatitore për gjykim dhe njëzet e tre (23) seanca të shqyrtimit kryesor. Përgjatë këtij viti janë dëgjuar **nëntë (9) dëshmitarë** të propozuar nga prokuroria. Identiteti i të gjithë dëshmitarëve ka qenë

konfidencial, pra emrat e tyre janë shënuar me shifra dhe është bërë ndryshimi i zërit dhe shtrembërimi i pamjes gjatë dhënies së deklaratës së tyre para trupit gjykues. Dëshmitarët që janë propozuar deri tani nga ZPS, kanë deklaruar në lidhje me atë që kanë dëgjuar, parë dhe përjetuar në qendrën e ndalimit në fshatin Zllash/Zlaš të komunës së Prishtinës/Priština. Për shkaqe të konfidencialitetit, një pjesë e madhe e deklaratave të tyre janë mbajtur në seanca private të cilat ishin të mbyllura për publikun. Seanca e radhës në këtë rast është mbajtur me 18 janar të vitit 2022, ku u vazhdua me dëgjimin e dëshmitarëve.

PROKURORI I SPECIALIZUAR KUNDËR HYSNI GUCATI DHE NASIM HARADINAJ

Gjykimi i dytë para Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) filloi në tetor të vitit 2021 në rastin Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Të pandehurit në këtë rast akuzohen për vepra penale kundër rendit publik dhe për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike.

Gjatë vitit 2021, në këtë rast janë mbajtur **njëzet e nëntë (29) seanca**, prej të cilave gjashtë (6) ishin konferenca mbi ecurinë e çështjes para fillimit të gjykimit, tre (3) konferenca përgatitore

për gjykim dhe njëzet (20) seanca të shqyrtimit kryesor. Gjykimi filloi më 7 tetor të vitit 2021, fillimisht janë dëgjuar **katër (4) dëshmitarë të prokurorisë** dhe më pas janë dëgjuar edhe **pesë (5) dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja e Gucatit**, prej të cilëve njëri ishte anonim. Po ashtu edhe i pandehuri Hysni Gucati është marrë në pyetje nga palët dhe trupi gjykues.

Gjykimi në këtë rast ka vazhduar edhe përgjatë muajit janar të vitit 2022.

PROKURORI I SPECIALIZUAR KUNDËR HASHIM THAÇIT DHE DHE TË TJERËVE

Rasti Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve, aktakuza e cilëve u konfirmua më 26 tetor 2020 dhe u bë publike më 5 nëntor 2020, vazhdon të jetë në procedurën paraprake ku janë duke u bërë përgatitjet për shqyrtimin kryesor i cili pritet të fillon pas disa muajve.

Të pandehurit në këtë rast akuzohen për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare.

Përgjatë vitit 2021, në këtë rast u mbajtën **shtatë (7) konferenca mbi ecurinë e çështjes**. ZPS ka vazhduar me nxjerrjen e materialeve dhe transferimin e dosjes tek pala mbrojtëse.

PROKURORI I SPECIALIZUAR KUNDËR PJETËR SHALËS

Në prill të vitit 2021 është bërë publike aktakuza e katërt para Dhomave të Specializuara, përkatësisht rasti Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës. I pandehuri akuzohet për krime lufte sipas të drejtës ndërkombëtare.

Paraqitja e parë e të pandehurit para gjykatësit të procedurës paraprake u mbajt me 19 prill 2021, në të cilën Pjetër Shala u vetë deklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Gjatë vitit 2021, përveç një (1) paraqitje të parë, u mbajtën edhe **katër (4) konferenca mbi ecurinë e çështjes**. I pandehuri është arrestuar më 16 mars të vitit 2021.

VËREJTJET E FDHK

Një numër i konsiderueshëm i dokumentacionit gjyqësor publik nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe, e të njëjtat i gjejmë vetëm në gjuhën angleze. Mungesa e përkthimi u pamundëson fillimisht të akuzuarve të kenë qasje në gjuhën që e kuptojnë, e pastaj edhe palëve në të tjera.

Procesi gjyqësor në rastin Prokurori kundër të Salih Mustafës ka qenë tepër i redaktuar, pjesa dërmuese e seancave kanë qenë të mbyllura për publikun, sa që edhe për monitoruesit profesional ka qenë e vështirë që të kuptohet se çfarë është duke ndodhur brenda shqyrtimit kryesor.

Projekti 'Monitorimi i punës dhe seancave gjyqësore të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe Përfshirja e Rinisë në Sektorin e Drejtësisë' përkrahët financiarisht nga Zyra Federale për Punë të Jashtme e Gjermanisë përmes Ambasadës Gjermanenë Prishtinë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe ai nuk pasqyron pikëpamjet e Ambasadës Gjermane në Prishtinë.